

**VENDIM**  
**Nr. 245, datë 20.4.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 101, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve, 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2.2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “ç”, shifra “7 250 000 (shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë” zëvendësohet me “13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë”;

b) nëndarjet “i”, “ii”, “iii”, të shkronjës “ç”, zëvendësohen me nëndarjet e mëposhtme:

i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë;

ii. blerjen e pjesëve të këmbimit për motor, si kollodok, biella, bronxina, këmisha, fasho, pistonat, testato dhe set guarnicionesh, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë;

iii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

iv. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatat, hidromotorin, pompë vaji friksion, multiplikator dhe tubacionet;

v. dokimi periodik i anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë. Dokimi periodik, sipas kushteve të klasit, përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike;

vi. riparim i përgjithshëm i anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milionë) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuar në dokimin periodik sipas nëndarjes “v”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine, ndërrim dërrase dhe impianti elektrik.”.

2. Fjalja e parë, e shkronjës “a”, të pikës 2.3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror, të zotëruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për subjekt, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferata të brendshme”.

3. Në nënpikën 2.5.1, shifra “950 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohet me shifrën “1 450 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë milionë) lekë”.

4. Nënpika 2.5.11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.5.11 Procedura e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët realizohet në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik”.

5. Pas nënpikës 2.5.12 shtohet pika 2.5.13, me këtë përmbajtje:

“2.5.13 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kryen procedura prokurimi publik gjatë vitit 2022, sipas fondeve shtesë për mbështetjen me naftë për bujqësinë, në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Efektet financiare shtesë prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh, për mbështetjen me naftë, do të përballohen nga paketa e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**